

DALËSE - IZLAZNA - OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

Nr. Br. No. 400-51/5
-11- Data Datum. Date. 14.07.2025



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE

DATE: RECEIVED / SUBMITTED: 14-07-2025

Njësia Org. Org. Unit	Str. i Klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. i faqeve Br. Stranica No. Pages
<u>03</u>	<u>47</u>	<u>1251</u>	<u>10</u>

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Prishtinë, 07.07.2025

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike, Kuvendi i Republikës së Kosovës

Lënda: Plani i veprimit për implementimin e rekomandimeve nga raporti i auditimit për vitin 2024

I/e nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), ka pranuar Raportin e Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2024, të përgatitur nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Bazuar në detyrimin ligjor lidhur me adresimin e rekomandimeve nga raporti vjetor i auditimit, ju lutem gjeni të bashkangjitur planin e veprimit për implementimin e rekomandimeve.

Jemi në dispozicionin e Juaj për ofrimin e sqarimeve shtesë.

Me respekt,

Jeton Qela

Sekretar i Përgjithshëm-MAPL
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Në kopje:

- Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së;
- Udhëheqësve të njësive organizative, dhe
- Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Nga: Elbert Krasniqi, Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal

PËR:

PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E
REKOMANDIMEVE

të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra
Kombëtare e Auditimit

Nr.	Komponenta e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit	Komente
1	<p>Çështja B1 - Mangësi në menaxhimin e pasurive financiare</p>	<p>Gjetja</p> <p>Rregullorja MF-NR 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 12.3 përcakton se, në momentin kur pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e pranimit nga ana e organizatës buxhetore, e cila e fiton të drejtën e pronësisë mbi pasurinë përkatëse, atëherë kategoria e investimeve në vijim mbyllët edhe në regjistrat e organizatës buxhetore pranuese dhe organizatës buxhetore bashkë financuese.</p> <p>Regjistri i pasurive kapitale të ministrisë ishte mbi-vlerësuar për 305,520€ si rezultat i mos mbylljes së projekteve të bashkë financuara pas</p>	<p>Rekomandimi B 1-</p> <p>Ministri duhet të sigurojë mekanizma dhe komunikim më efektiv në mes të palëve të përfshira në projektet me bashkëfinancim, në mënyrë që njoftimet të bëhen në kohë dhe bartja e pronësisë së pasurive të bëhet sipas rregullave në fuqi. Gjithashtu, të ndërmerren veprime për</p>	<p>Në lidhje me rekomandimin B 1</p> <p>MAPL në procesin e financimit të projekteve kapitale ka kerkuar ne vazhdimesi nga komunat pranimet teknike. Ne lidhje me projektet ne fjale:</p> <p>• Projekti “Turizmi i aventurës - vlerë për zhvillim të qëndrueshëm të Pejës”</p> <p>Pas kërkesës se MAPL-se, Ministria e Financave e ka ndërruar statusin e projektit ne</p>	<p>-Menaxhmenti i MAPL, - DZHQK, - DBF</p>	<p>Gjatë tërë vitit 2025</p>	

	<p>përfundimit të tyre. Këto raste përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Projekti “Turizmi i aventurës - vlerë për zhvillim të qëndrueshëm të Pejës” kishte përfunduar dhe pranimi teknik ishte bërë në korrik të vitit 2024. Pagesa e kryer nga ministria në vlerë 165,000€ vazhdon të figuroj si investim në vijim në regjistrat e pasurive të ministrisë. Në tetor të vitit 2024 ministria kishte drejtuar në Thesar një kërkesë për fshirje të pasurisë nga regjistri i saj por nuk kishte marrë një përgjigje. Kjo pagesë është e regjistruar edhe në regjistrin e pasurive të komunës si investim në vijim; • Projekti “Rregullimi urban dhe ndriçimi publik në fshatrat Vitomiricë, Dubovë dhe Ozdrim” në Komunën e Pejës kishte përfunduar dhe pranimi teknik ishte bërë në prill të vitit 2023. Pjesa e financuar nga ministria për këtë projekt në vlerë 50,000€, vazhdon të figuroj si investim në vijim në regjistrin e 	<p>përditësimin dhe mbylljen e investimeve në regjistrin e pasurive, në përputhje me dokumentacionin mbështetës.</p>	<p>Investim në vijim i mbyllur.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Projekti “Rregullimi urban dhe ndriçimi publik në fshatrat Vitomiricë, Dubovë dhe Ozdrim” në Komunën e Pejës Pas kërkesës së MAPL-se, Ministria e Financave e ka ndërruar statusin e projektit në Investim në vijim i mbyllur. • Projekti “Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik” në Komunën e Klinës Pas kërkesës së MAPL-se, Ministria e Financave e ka ndërruar statusin e 			
--	--	--	---	--	--	--

	<p>pasurive të ministrisë. Në nëntor të vitit 2024 ministria kishte drejtuar në Thesar një kërkesë për fshirje të pasurisë nga regjistri i saj por nuk kishte marrë një përgjigje. Pagesa e njejtë ishte regjistruar edhe në regjistrin e komunës si investim në vijim;</p> <p>• Projekti “Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik” në Komunën e Klinës kishte përfunduar dhe pranimi teknik ishte bërë në gusht të vitit 2022. Pagesa e financuar nga ministria për këtë projekt në vlerë 45,000€, vazhdon të figuroj e regjistruar si investim në vijim në regjistrin e pasurive të ministrisë; si dhe</p> <p>• Projekti “Rregullimi i hapësirave të jashtme dhe renovimi i shkollës ShMFT-Shaban Spahija” në Pejë, kishte përfunduar dhe pranimi teknik ishte bërë në qershor të vitit 2023. Dy pagesa në vlerë të përbashkët 45,520€ të ekzekutuara nga ministria për këtë projekt, ende figuronin si</p>		<p>projektit ne Investim ne vijim i mbyllur.</p> <p>• Projekti “Rregullimi i hapësirave të jashtme dhe renovimi i shkollës ShMFT-Shaban Spahija” në Pejë, Pas kërkesës se MAPL-se, Ministria e Financave e ka ndërruar statusin e projektit ne Investim ne vijim i mbyllur.</p>			
--	--	--	--	--	--	--

	<p>investim në vijim në regjistrin e pasurive të ministrisë.</p> <p>Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së komunikimit të mirëfilltë në mes të ministrisë dhe komunave, për progresin e projekteve të bashkëfinancuara dhe bartjes së pronësisë sipas rregullave.</p> <p>Ndikimi</p> <p>Shuma e financuar nga ministria e mbajtur në regjistrin e pasurisë si investim në vijim edhe pas përfundimit të projektit, ndikon në mbivlerësim të gjendjes së pasurive të ministrisë. Krahas kësaj, si rezultat i dyfishimit të vlerës së regjistruar për të njejtat projekte nga dy entitete, ka ndikim në mbivlerësimin e gjendjes së përgjithshme të pasurive në Raportin Vjetor Financiar të konsoliduar për vitin 2024.</p>					
--	---	--	--	--	--	--

2	<p>Çështja A1 - Mangësi në raportim të pasurive jo-kapitale në PFV</p>	<p>Gjetja</p> <p>Rregullorja MF-NR 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 24 (pika 2.2) përcakton: Paraqitja në pasqyrat vjetore financiare duhet të bëhet nga e-pasuria për pasuritë me vlerë nën 1,000 € dhe afat të përdorimit mbi një vit dhe stoqet. Pasuritë jo kapitale në vlerë 33,001€, të blera në vitin 2024, nuk ishin raportuar në PFV edhe pse këto pasuri ishin regjistruar në regjistrin e pasuria. Me rastin e përgatitjes së PFV-ve nuk ishte përdorur baza e duhur për raportim. Kjo kishte ndodhur si pasojë e një gabimi teknik dhe në mungesë të kontrolleve të mjaftueshme për raportim të vlerës së plotë dhe të saktë të pasurive jo kapitale në PFV.</p> <p>Ndikimi</p> <p>Ky gabim ka ndikuar në nënvlerësim të gjendjes së pasurive jo kapitale dhe</p>	<p>Rekomandimi A 1</p> <p>Ministri duhet të siguroj kontrollë më efektive gjatë përgatitjes dhe raportimit të informatave financiare në PFV, në mënyrë që të evitohen gabimet dhe gjendja e pasurive jo kapitale e prezantuar në PFV të jetë e plotë dhe e saktë.</p>	<p>Lidhur me rekomandimin A1</p> <p>MAPL ka ndërmarrë hapat e duhur dhe e ka përmirësuar gjendjen e pasurisë nën vlerën 1,000.00€</p>	<p>-Zyrtari i pasurise</p>	<p>Gjatë tërë vitit 2025</p>	
---	---	---	--	--	----------------------------	------------------------------	--

		prezantim të informatave jo të plota dhe të sakta në PFV.						
--	--	--	--	--	--	--	--	--

3	<p>Çështja A2 - Mos-funksionim i Komitetit të Auditimit</p>	<p>Gjetja</p> <p>Udhëzimi administrativ nr. 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit në subjektin e sektorit publik, përkatësisht neni 6.1 përcakton: Komiteti i Auditimit emërohet nga udhëheqësi i subjektit të sektorit publik dhe përbëhet nga tre (3) ose pesë (5) anëtarë.</p> <p>Mandati i Komitetit të Auditimit në MAPL kishte skaduar në qershor të vitit 2024. Gjatë periudhës së funksionimit të këtij komiteti, ai kishte mbajtur një takim për vitin 2024. Megjithatë, Ministria nuk kishte themeluar ende komitetin e ri.</p> <p>Ministria ishte njoftuar me kohë nga NJAB për përfundimin e mandatit të Komitetit të Auditimit, por në mungesë të prioritizimit të kësaj çështje nga menaxhmenti, nuk ishin ndërmarrë masa për emërim të ri të këtij funksioni.</p>	<p>Rekomandimi A 2</p> <p>Ministri duhet të siguroj që në afat sa më të shpejtë kohor të funksionalizohet Komiteti i Auditimit në përputhje me kërkesat ligjore, në mënyrë që të zbatohet mbikëqyrja dhe mbështetja e NjAB-së si dhe të sigurohet pavarësia e kësaj njësie.</p>	<p>Lidhur me rekomandimin A 2 -</p> <p>Kanë filluar procedurat e hapjes së thirrjes për zgjedhjen e anëtarëve të jashtëm.</p>	<p>- Menaxhmenti i larte</p>	<p>Gjatë tërë vitit 2025</p>	
---	--	--	--	--	------------------------------	------------------------------	--

		Ndikimi Mungesa e një Komiteti të Auditimit funksional ndikon në mbikëqyrjen efektive të proceseve të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar, si dhe pamundëson mbikëqyrjen e punës së auditimit të brendshëm dhe marrëdhënies së tij me menaxhmentin në drejtim të përmirësimit të kontrollit të brendshëm.					
--	--	--	--	--	--	--	--